“Jepmani besën se nuk do t'i shoqëroni Allahut asgjë, nuk do të vidhni, nuk do të bëni zina

Ubade ibn Samiti (Allahu qoftë i kënaqur me të!), pjesëmarrës në Luftën e Bedrit me të Dërguarin e Allahut dhe një prej pjesëtarëve të Besëlidhjes së Akabesë, transmeton se i Dërguari i Allahut , përreth të cilit po qëndronin një grup shokësh të tij, ka thënë: “Jepmani besën se nuk do t'i shoqëroni Allahut asgjë, nuk do të vidhni, nuk do të bëni zina, nuk do t'i mbysni fëmijët tuaj, nuk do të bëni shpifje në moralin e njëri-tjetrit, dhe nuk do të kundërshtoni kur të urdhëroheni për të mirë. Cilido prej jush që e mban besën e tij, do të shpërblehet nga Allahu, e kushdo që bie në ndonjërën prej këtyre (përveç idhujtarisë) dhe ndëshkohet në dynja, kjo i mjafton si shpagim (për mëkatin). Ndërkaq, kushdo që bie në ndonjërën prej këtyre (përveç idhujtarisë), e pastaj Allahu ia mbulon ato, atëherë çështja e tij i përket Allahut: nëse do, e fal, e nëse do, e dënon.” Atëherë ia dhamë besën për këtë.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Ubade ibn Samiti (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ishte ndër pjesëmarrësit në betejën e madhe të Bedrit dhe ishte udhëheqësi i popullit të tij, që doli përpara për të dhënë besën për mbështetjen e të Dërguarit të Allahut në natën e Akabesë në Mina, - kur i Dërguari i Allahut ishte në Mekë para se të emigronte në Medinë - njoftoi se Profeti ishte i ulur mes shokëve të tij dhe u kërkoi atyre t'i jepnin besën për disa çështje: Së pari: të mos i shoqërojnë Allahut asgjë në adhurim, pavarësisht sa e vogël qoftë ajo. Së dyti: të mos vjedhin. Së treti: të mos bëjnë zina (kurvëri). Së katërti: të mos i vrasin fëmijët e tyre; as djemtë nga frika e varfërisë dhe as vajzat nga frika e turpit. Së pesti: të mos bëni shpifje në moralin e njëri-tjetrit. Së gjashti: të mos e kundërshtojnë Profetin kur bëhet fjalë për atë që është e drejtë dhe urdhërim për të mirë. Kushdo që mbetet i palëkundur në këtë besë dhe i përmbahet asaj, shpërblimi i tij është tek Allahu. Sa u përket atyre që kryejnë ndonjë nga gjërat e përmendura, përveç shirkut , dhe ndëshkohen për to në këtë botë, përmes dënimit të përcaktuar fetar (ar. hadd), kjo shërben si shlyerje (kefaret) për të dhe mëkati i tij fshihet. Megjithatë, kushdo që kryen ndonjë prej këtyre veprave dhe Allahu ia mbulon atë, çështja e tij i mbetet Allahut; Ai ose mund ta falë, ose mund ta ndëshkojë. Të gjithë ata që ishin të pranishëm i dhanë besë e tyre për këtë.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/66210